

V E N D I M
Nr. 645, datë 12.12.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË
PREKEN NGA ZGJERIMI I NËNSTACIONEVE ELBASAN 400 KV, ELBASAN 220 KV,
DHE NGA NDËRTIMI I LINJËS 220 KV NDËRMJET TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i nënstacioneve Elbasan 400 kV, Elbasan 220 kV dhe nga ndërtimi i linjës 220 kV ndërmjet tyre, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH-, sh.a.-së, Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen dhe pronarët e pasurive që dëmtohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi në shumën e përgjithshme prej 9 167 098 (nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, me sipërfaqe 2 900 m² truall, 232 m² ndërtesë, 5290 m² tokë arë, 1 400 m² parcelë me misër, 697 m² parcelë me jonxhë.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e miratuara për KESH, sh.a.-së, në zërin "Kosto lokale për shpronësime".

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit në shumën 287 000 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të jenë në ngarkim të KESH, sh.a.-së, kërkuesit për shpronësim.

6. Procedura e shpronësimit të fillojë brenda tremujorit të katërt të vitit 2002 dhe të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit 2003.

7. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999.

8. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH, sh.a.-ja, Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Republika e Shqipërisë
Rrethi Elbasan

Lista e pronarëve që preken nga shpronësimi për ndërtimin e nënstacioneve Elbasan 400 kV, Elbasan 220 kV, si dhe nga linja 220 kV ndërmjet tyre

Lloji i pasurisë së paluajtshme që preket dhe shpronësohet nga zgjerimi i nënstacionit Elbasan 400 kV: kantier prodhimi material ndërtimi dhe tokë arë.

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë	Sip. në m ²	Vlera totale e pasurisë	Adresa:	Shënime
1	Arif Terziu	a)Truall b)ndërtesë	2 900 232	6.016.398 lekë	Lagjia:Fushë-Mbret Elbasan	I regjistruar
2	Bexhet Limani (përdorues)	Tokë arë	2653	Nuk kompesohet Pronë shtetërore	Lagjia: Fushë-Mbret Elbasan	Pronë-shtetërore dhënë në përdorim

Mbyllet me numër rendor 2 (dy)

Lloji i pasurisë së paluajtshme që preket dhe shpronësohet nga zgjerimi i nënstacionit Elbasan 220 kV si dhe nga ndërtimi i linjës 220 kV ndërmjet dy nënstacioneve: Tokë-arë.

Nr	Emër mbiemër	Nr. kadastral	Lloji i pasurisë	Sip.në m2	Çmimi lekë/m2	Vlera e pasurisë që kompensohet shprehur në lekë	Adresa	Shënime
1	Veli Leshanaku	72	Tokë arë	1 400	1200	1 680 000	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
2	Arben Leshanaku	72	Tokë arë	697	"	836 400	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
3	Jakup Leshanaku	72	Tokë arë	42	"	50 400	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
4	Nuredin Leshanaku	69	Tokë arë	42	"	50 400	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
5	Selman Leshanaku	140	Tokë arë	15	"	18 000	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
6	Met Leshanaku	140	Tokë arë	15	"	18 000	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
7	Banush Salla	141	Tokë arë	86	"	103 200	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
8	Agim Hidri	189	Tokë arë	25.5	"	30 600	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
9	Zyber Kraoba	198	Tokë arë	34	"	40 800	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
10	Jakov Bërdufi	37	Tokë arë	52	"	62 400	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
11	Misir Myrto	331	Tokë arë	56	"	67 200	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
12	Xhaferr Pajenga	331,2	Tokë arë	43	"	51 600	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi
13	Shpëtim Gjeli	332,2	Tokë arë	21.5	"	25 800	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi
14	Xhavit Hani	339 0/1	Tokë arë	36	"	43 200	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi
15	Shpresa Ruci	338 4	Tokë arë	30	"	36 000	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi
16	Bexhet Limani (përdorues)	428	Tokë arë	42	"	Nuk kompensohet Pronë shtetërore	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi

Mbyllet me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë)

3. Lloji i pasurisë që dëmtohet nga shpronësimi: Kulturë bujqësore misër dhe jonxhë:

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë së dëmtuar	Sip.e mbëdhjellë në m2	Vlefte totale e pasurisë që zhdëmtohet	Adresa:
1	Veli Leshanaku	Parcelë me misër	1400	23 300 lekë	Bradashesh-Elbasan
2	Arben Leshanaku	Parcelë me jonxhë	697	13 400 lekë	Bradashesh-Elbasan

Mbyllet me numër rendor 2 (dy)

Shënim: Vlera totale e kompensimit të pronarëve 9 167 098 (nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

Shpenzime procedurale (publikim, kancelari, shpërblim) 287 000 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

Vlera e përgjithshme e shpronësimit 9 454 098 (nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë e katërmijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë.